

VENDIM
Nr. 184, datë 10.9.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ENERGY PLUS” SHPK, PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT KRYESOR TË SAJ,
NËPËRMJET SHITJES SË 100% TË KUOTAVE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neni 67, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; neni 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.2, të “Kushteve të licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike”; pikës 5.2, të “Kushteve të licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 118/3 prot., datë 7.9.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k., me NUIS K91928002U, është mbajtëse e licencës nr. 112, seria PV10K, për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 110, datë 22.12.2010, të ndryshuar, si dhe licencës nr. 113, seria T10P, për tregtimin e energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 22.10.2010.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 838 prot., datë 21.7.2021, shoqëria ka kërkuar nga ERE autorizimin për transferimin e kuotave që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë.

- Më tej, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 838/2 prot., datë 18.8.2021 dhe nr. 838/4 prot., datë 30.8.2021, shoqëria ka depozituar në ERE sqarime dhe dokumentacion shtesë.

- Kërkesa e shoqërisë vjen në zbatim të pikës 6.2, të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike dhe pikës 5.2, të kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike, ku përcaktohet si vijon:

Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose nëse aksionari/ortaku që kontrollon interesat e të licencuarit ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, licenca bëhet nul (e pavlefshme) dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re, në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie licence.

- Shoqëria ka paraqitur dokumentacion të nevojshëm për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut kryesor.

- Për sa i përket miratimit të autoritetit kontraktor për këtë transferim, shoqëria ka informuar se paralelisht me kërkesën drejtuar ERE-s, i është drejtuar dhe autoritetit kontraktor për marrjen e miratimit për transferimin e kuotave dhe sapo të pajiset me këtë miratim, do ta vendosë në dispozicion të ERE-s. Për këtë ka vendosur bashkëlidhur shkresën nr. 0709/2254 prot., datë 21.7.2021, drejtuar MIE-s, me anë të së cilës ka kërkuar miratimin për transferimin e 100% të kuotave.

- Në këto rrethana dhe në zbatim të parashikimeve të përcaktuara në nenin 67, të Kodit të Procedurave Administrative, u pa e arsyeshme që të shtyhet me 30 ditë vendimarrja e Bordit të ERE-s, me qëllim vendosjen e komunikimit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe marrjen e informacionit përkatës për fazën në të cilën ndodhet dhënia e miratimit për këtë transferim nga MIE, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1 Shtyrjen me 30 ditë të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të saj, nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti